



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. të datës 21.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës Lot II” me nr. të prokurimit 616-22-11624-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Hedhet poshtë si e palejuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. të datës 21.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës Lot II” me nr. të prokurimit 616-22-11624-5-1-1.**
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 21.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës Lot II” me nr. të prokurimit 616-22-11624-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim nuk është parashtruar në përputhje me nenin 108/A paragrafin 1

të ligjit në fuqi për prokurimin publik si dhe nenin 59 paragrafin 1 të RRPP lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 26 të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ("OSHP") me datë 03.11.2023 ka marrë vendimin 2023/0620 përmes të cilit ka konstatuar se parashtruesi "Milenium Konstruktion" Sh.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës Lot II" me nr. të prokurimit 616-22-11624-5-1-1 ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht duhet eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Konkretisht në faqen nr. 9 të vendimit të sipërcituar të Panelit Shqyrtues në OSHP është konstatuar saktësisht si vijon: "sqarimet e dhëna nga OE ankues kanë qenë jo-bindëse për AK-në, kështu që rrjedhimisht duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër, OE ankues nga ana e panelit klasifikohet si i papërgjegjshëm lidhur me këtë aktivitet prokurimi andaj eliminohet nga pjesëmarrja në të".

Nga sa u tha më sipër ju edhe përmes letrës standarde mbi tenderuesin e eliminuar jeni njoftuar se eliminimi juaj i ka paraprirë procesit të rivlerësimit për shkak të vendimit të OSHP 2023/0620. Së këndejmi ju nuk mund të dëshmoni asnjë interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit dhe për pasojë nuk jeni palë e interesuar në raport me këtë aktivitet të prokurimit dhe as në raport me kërkesën tuaj për rishqyrtim në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP është përcaktuar se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Tutje përmes nenit 108/A paragrafin 1 të ligjit në fuqi për prokurimin publik si dhe nenit 59 paragrafit 1 të RRPP është përcaktuar se vetëm palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim. Duke marrë parasysh që ju nuk e keni statusin e palës së interesuar, nuk posedoni as mundësinë për të parashtruar këtë kërkesë për rishqyrtim. Në këtë mënyrë është konstatuar se kërkesa juaj për rishqyrtim është e palejuar dhe duhet të hedhet poshtë në kuptim të nenit 62 par. 62.1 nënpar. b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 59 paragrafin 59.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.11.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net